



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.23/2018
Prishtinë, më 30.3.2018, në orën 09:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila dhe Memli Krasniqi, anëtarë.

Munguan: Dardan Molliqaj, Gani Dreshaj, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Dardan Abazi, INDEP; Adelina Hasani, KDI; Arbenita Marmullaku, RTK-Radio dhe Besjana Bajrami, “Ekonomia Online”.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.01/25, datë 22.1.2018 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-037 për Meteorologji;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-041 për kërkesat teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;
5. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.01/25,, datë 22.01.2018 për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;

Sala Berisha Shala, kryetare, tha që e kemi pranuar Vendimin e Qeverisë, me çrast janë propozuar kandidatët për Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit - AKP-së. Materiali në formë fizike iu është shpërndarë me datën 19.3.2018. Lista e propozuar përbehet prej 6 kandidatëve, 3 të parët kanë qenë edhe në mandatin e aktual, tani vetëm po ju vazhdohet, një është nga Bashkimi Sindikatave të Pavarura të Punëtorëve dhe 2 janë të rinj, dhe sipas ligjit i plotësojnë kushtet për emërim. Siç jemi të njoftuar në këtë Agjenci kemi vakum institucional në mungesën e plotë të Bordit të AKP-së, andaj, ju ftoj t'ia propozojmë Kuvendit miratimin e listës së kandidatëve të propozuar nga Qeveria për këtë Bord.

Komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të emërohen 6 (gjashtë) kandidatët e propozuar nga Qeveria, për anëtarë të Bordit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si vijon:

- 1. Hasime Mazreku,*
- 2. Skender Komoni,*
- 3. Ranko Gjokiq,*
- 4. Qemajl Behrami;*
- 5. Bekim Selimaj dhe,*
- 6. Avni Ajdini.*

2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha -Shala, kryetare e Komisionit.

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-037 për Meteorologji;

Sala Berisha-Shala, kryetare: Komisionet e përhershme nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje për këtë projektligj, andaj, raporti me rekomandime procedohet në lexim të dytë në Kuvend.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

1.Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 06/L-037 për Meteorologji.

2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për Projektligjin nr.06/L-041 për kërkesat teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;

Kryetarja, theksoi për këtë projektligj, Komisionet e përhershme nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje, andaj, raporti me rekomandime të procedohet për lexim të dytë në Kuvend.

Hykmete Bajrami, theksoi se duhet të shtohet dhe një amendament i ri te neni 16, paragrafi 2, fjala “mund të” fshihet. Ky amendament heq dilemat dhe për ta qartësuar më mirë dispozitën e fshijmë fjalën “mund të”. Është amendament shtesë në renditje, dhe duhet të jetë amendamenti i 9 (nëntë) dhe ky amendament nuk i ka kaluar procedurat ne komisione të përhershme andaj, duhet të arsyetohet në seance nga kryetarja.

Propozimi i znj. Hykmete Bajrami, u përkrah nga Komisioni.

Pas debatit, komisioni nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit,*
- 2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

5. Të ndryshme.

Çështjet vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 9:45

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Sala Berisha Shala